



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 118, datë 03.09.2019

**PËR VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË
KANDIDATES ZHAKLINA PETO PËR VENDIN VAKANT NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, VAKANCË E PLOTË, TË SHPALLUR NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 229, pikës 1 të nenit 234, 235 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 44 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”,

nisur nga vendimi nr. 201 datë 22.08.2019 i Gjykatës Administrative të Apelit që ka disponuar shfuqizimin e vendimit nr. 108 datë 02.08.2019 dhe vendimit nr. 109 datë 02.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vijimin me përparësi të procedurës së verifikimit të kandidaturës së znj. Zhaklina Peto për vendin në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian Dvorani

